



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1430 Prot.

Korçë, më 03 / 09 / 2019

VENDIM

Nr. 432, datë 03.09.2019

**“PËR PËRCAKTIMIN E DETYRIMIT FINANCIAR TË ALEANCËS
FRANCEZE TË TIRANËS (AFT) PËR ZHVILLIMIN E PROVIMIT DELF TP,
NË KUADËR TË MARRËVESHJES QË DO TË LIDHET NDËRMJET
SHËRBIMIT PËR BASHKËPUNIM DHE VEPRIMTARI KULTURORE TË
AMBASADËS SË FRANCËS (SCAC), ALEANCËS FRANCEZE TË TIRANËS
(AFT) DHE UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË”**

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 03 / 09 / 2019, pasi mori në shqyrtim dhe diskutoi në lidhje me shkresën nr. 1416 prot., datë 02.09.2019, “Propozim për përcaktimin e detyrimit financiar të ATF për zhvillimin e provimit DELF TP”, paraqitur nga Rektorati i Universitetit, në të cilën, në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në draftin e marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet *Shërbimit për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore të Ambasadës së Francës (SCAC), Aleancës Franceze të Tiranës (AFT) dhe Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë*, neni 7, propozohet që shuma, që i kalon Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë për të mbuluar shpenzimet që rrjedhin nga zhvillimi i provimit DELF TP të caktohet në masën 10% të tarifës së regjistrimit për çdo kandidat, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pikat 1 dhe 3/a dhe neni 47, si dhe në propozimin e mësipërm,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Rektoratit të Universitetit paraqitur Bordit të Administrimit me shkresën nr. 1416 prot., datë 02.09.2019, “Propozim për përcaktimin e detyrimit financiar të ATF për zhvillimin e provimit DELF TP”.

2. Të përcaktojë detyrimin financiar të ATF për zhvillimin e provimit DELF TP në masën 10% të tarifës së regjistrimit për çdo kandidat, shumë që i kalon Universitetit "Fan S. Noli", Korçë për të mbuluar shpenzimet që rrjedhin nga zhvillimi i këtij provimi, në kuadër të marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet Shërbimit për bashkëpunim dhe veprimtari kulturore të Ambasadës së Francës (SCAC), Aleancës Franceze të Tiranës (AFT) dhe Universitetit "Fan S. Noli", Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. Mamica Ne